

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nxitimi i SPAK ndaj kreut të SHISH, përballë brishtësisë së një institucioni delikat
ADRESA	https://www.gazetatema.net/blogu-tema/nxitimi-i-spak-ndaj-kreut-te-shish-perballe-brisht-esise-se-nje-instit-i587720
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 18:45:42 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	22 shtator 2026, 15:00:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8ffb8952f6daa5d2f6e99f28fffb9fd77db1694017b9e7885e358ad1953b8f21
TEKSTI	bb2f78dea3c6e3e41b9b1d8fd9bfc7fe8fc14433e9ab3b1b9d6eb1504fdfe38f
PAMJA	d1e702d65b1a35ae327d1575d93b337d98920dbdff6dc3fa1be9289a7a47ad57

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	5bd5edf32ee3c20faabf3c4caf663f083b8d88773421fec87ec85fafedbf7864
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/5bd5edf32ee3c20faabf3c4caf663f083b8d88773421fec87ec85fafedbf7864>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)

English

ie 'Zelensky liet ne OKB: Moska ka pesuar humbje poshteruese! Vetem nje njeri deshiron lulte ne UkraineC'mimet e banesave t'renojne rritjen, por nuk u len duhen me shum fundit

Nxitimi i SPAK ndaj kreut të SHISH, përballë brishtësisë së një institucioni delikat

TemA

22 Shtator 2026, 17:00Blog TEMA



Nga Musa Kurtulaj

Arresti shtëpiak i drejtueses së SHISH-it në një ditë shumë të veçantë: urgjencë e domosdoshme apo një veprim që cenon interesin e shtetit? -

Pasi u bë publike masa e arrestit shtëpiak ndaj drejtueses së Shërbimit Informativ të Shtetit, Vlora Hyseni, si dhe pezullimi i saj nga detyra, të shpallura nga SPAK dhe të miratuara nga GJKKO, më e pakta që mund të thuhet, sipas mendimit tim, është se kemi të bëjmë me një veprim të papërgjegjshëm të këtyre dy institucioneve, ndersa më për tepër mund ta quajmë kurth dhe karshillek ndaj shtetit.

Hyseni, në momentin kur u bë publik vendimi, nuk ndodhet në Shqipëri, por merr pjesë në një konferencë ndërkombëtare të drejtuesve të shërbimeve sekrete. Ndërkohë, as kryeministri Edi Rama nuk ndodhet në Shqipëri, pasi merr pjesë në punimet e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në SHBA. Në këto rrethana lindin natyrshëm pyetjet: pse duhej zgjedhur pikërisht kjo ditë për të shpallur një masë të tillë ndaj drejtueses së shërbimit informativ të vendit? Pse e gjitha kjo urgjencë?

A nuk mund të pritej edhe 24 orë, deri në kthimin e saj dhe të Kryeministrit në Tiranë? A kishte ndonjë rrezik të menjëhershëm që kërkonte me patjetër që vendimi të merrej e të bëhej publik pikërisht në këto momente?

Drejtuesi i Shërbimit Informativ të Shtetit është një funksionar me rëndësi të jashtëzakonshme për sigurinë kombëtare. Për këtë arsye, një vendim i tillë nuk mund të shihet thjesht si një procedurë e zakonshme gjyqësore që prek një individ. Kur bëhet fjalë për drejtuesin e shërbimit sekret të një vendi, çdo veprim i

tillë ka edhe një dimension institucional, diplomatik dhe të sigurisë kombëtare. Dhe këtu lindin të tjera pyetje: si është perceptuar ky lajm në një konferencë ndërkombëtare ku marrin pjesë drejtuesit e shërbimeve sekrete të vendeve partnere? Çfarë mesazhi u është përcjellë atyre nga Shqipëria përmes faktit se drejtuesja e shërbimit informativ shqiptar ndodhet në një takim të tillë ndërkombëtar, në të njëjtën kohë bëhet publik lajmi se ndaj saj është caktuar masa e arrestit shtëpiak? A nuk i bëhet një dëm i konsiderueshëm imazhit të Shqipërisë në këtë rast?! Në këto rrethana SPAK-u, për mendimin tim, ka një detyrim shumë të madh e të shpejtë për ta sqaruar opinionin publik dhe institucionet e shtetit shqiptar mbi rrethanat që, sipas tij, e bënë të domosdoshëm këtë nxitim.

Nuk mjaftojnë pesë fjalë të zakonshme, si ato që mund të përdoren në njoftimet për arrestimin e një personi të zakonshëm. Në këtë rast kemi të bëjmë me drejtuesen e institucionit që ka përgjegjësi të drejtpërdrejtë për informacionin e sigurisë kombëtare. Çfarë e bëri kaq urgjent këtë veprim? Çfarë rrezikohet nëse pritej edhe 24 orë? Këto e të tjera, janë pyetje që kërkojnë përgjigje të qarta; bindëse, e jo llafe plotësuese për mediat e rrjetet sociale.

Të shohim pak më larg. Po Kosova? Po siguria gjithë kombëtare?

Një tjetër element që, sipas meje, nuk mund të lihet jashtë kësaj çështjeje është situata e krijuar në Kosovë dhe zhvillimet që lidhen me ish-drejtimesit e UÇK-së në Hagë. Kosova, për shkak të specifikës së saj dhe rolit që ka në zhvillimet rajonale, përbën një çështje me rëndësi të veçantë për shtetin shqiptar e jo vetëm... Situata atje duhet ndjekur me vëmendje të jashtëzakonshme jo vetëm në planin juridik, politik dhe diplomatik, por edhe në aspektin e sigurisë. Në këtë drejtim, një rol të rëndësishëm ka edhe Shërbimi Informativ i Shtetit. Shërbimi informativ nuk është institucion që mund të bëjë sehir përballë zhvillimeve të tilla në Kosovë e rajon. Detyra e tij është të mbledhë, analizojë dhe vlerësojë informacionin e nëndheshëm që i nevojitet shtetit për të kuptuar më mirë zhvillimet dhe rreziqet që mund të prekin sigurinë kombëtare, si dhe të bashkëpunojë me shërbimet partnere euroatlantike.

Në këtë situatë të ndërlikuar në Kosovë dhe në rajon, ku veprojnë shumë faktorë e aktorë dhe ku gjëndjet e tensionuara shfrytëzohen nga interesa të ndryshme, informacioni i sigurisë merr një rëndësi tejet të veçantë.

Prandaj lind pyetja: a është marrë parasysh edhe ky dimension nga SPAK + GJKKO kur vendosen të ndërmerrin dhe të bëjnë publik këtë veprim ndaj drejtueses së SHISH-it? A është vlerësuar ndikimi që një masë e tillë mund të ketë në funksionimin e këtij institucioni edhe në marrëdhëniet e tij me shërbimet partnere? A është vlerësuar situata e veçantë në të cilën ndodhet rajoni? Dhe mbi të gjitha: A ishte vërtet e pamundur të pritej edhe 24 orë? Përgjigjësja e kësaj pyetjeje mbetet pezull.

Nëse veprimi i SPAK-ut dhe GJKKO-së ka qenë i diktuar nga një domosdoshmëri ligjore dhe nga rrethana që nuk lejonin asnjë shtyrje, atëherë kjo duhet t'i shpjegohet qartë publikut.

Nëse ka pasur arsye konkrete që e bënin të pamundur pritjen e kthimit të drejtueses së SHISH-it në Tiranë, ato duhet të bëhen të kuptueshme, aq sa e lejon ligji dhe natyra e një hetimi të kësaj rëndësie. Përndryshe, në opinionin publik mbetet përshtypja se një veprim me pasoja të rëndësishme institucionale, është ndërmarrë me një nxitim të pakuptueshëm.

Kjo është ajo që shqetëson më shumë. Kuj i shërben ky nxitim?

Shtetit shqiptar? Sigurisë kombëtare? Bashkëpunimit me partnerët tanë euroatlantikë? Interesit kombëtar shqiptar?

Nuk është e drejtë që këto përgjigje ti japim ne duke hamendësuar. Është detyrë e institucioneve përkatëse të japin shpjegimet e nevojshme.

Uroj sinqerisht që të jem gabim dhe që SPAK-u e GJKKO-ja të rezultojnë të kenë vepruar mbi bazën e një domosdoshmërie të qartë ligjore dhe institucionale, të cilën publiku ende nuk e njeh. Por pikërisht për shkak të rëndësisë së jashtëzakonshme të këtij rasti, institucionet kanë detyrimin të flasin më qartë. Kur preket nxitimthi drejtuesi i shërbimit informativ të vendit, nuk kemi të bëjmë vetëm me fatin e një individi. Kemi të bëjmë me një çështje që lidhet drejtpërdrejt me institucionet e shtetit, sigurinë kombëtare, partneritetet ndërkombëtare dhe interesin kombëtar shqiptar. SPAK+GJKKO, me këtë veprim - vendim nxitimthi, a i kanë shërbyer interesit kombëtar?!

10 Komente



Ai e di

22 Shtator 2026, 17:18

Rama e shkarkoi fare nga Amerika.

← [Përgjigjuni](#)

👍 0 🗳️ 0 ❤️ 0



Besnik

22 Shtator 2026, 17:18

Nuk eshte kjo pyetja qe shtrohet, por shkrimin e mbeshtes plotesisht. Me sa duket(hamendje) drejtesia eshte e tejingopur me para dhe nuk don te punoje me, eshte e zhytur koke e kembe ne krim dhe korrupsion. Po po, drejtesia gjykates, prokurore, hetues, drejtues te kesaj drejtesie, deri edhe te pastuesja e gjukates a po e prekororisë a hetuesise e te gjithe duan qe te bjere shteti per ndonje gje fare te vogel. Duan te mos punojne me me qellim te justifikojne krimet e tyre!

← [Përgjigjuni](#)

👍 2 🗳️ 0 ❤️ 0



?

22 Shtator 2026, 18:23

Dmth e akuzojnë kot zonjën dhe agasin?

← [Përgjigjuni](#)

👍 0 🗳️ 0 ❤️ 0



Kerrici i Faro spiunit

22 Shtator 2026, 19:01

Ky eshte reagimi i pare i bandes mafjoze te prokuroreve dhe gjyqtareve sharlatane kunder Qeverise si hakmarje qe nuk ja plotesoi idiotesine grykesine per ritjen e majme te pagave.SPAK dhe Gjykata e Posacme jane kthyer ne zyra gestapo qe i kane mbushur burgjet me te paraburgosur pa prova, por vetem me pergjime , spiunlliqe dhe letra anonime.

↩ [Përgjigjuni](#)

👍 5 🗳️ 0 ❤️ 0

T

Taksapagues i ketij vendi

22 Shtator 2026, 19:57

Kujt i sherben ky nxitim i ketyre organeve mbase vet drejtuesia e SHISH duhet te flase hapur dhe pa frike , mbasi autori i shkrimit me te drejte ngre shume pikpyetje qe jane bindse.Kujt i sherben ne keto momente me kaq nxitim per mire apo per keq.Shqiptaret duhet ta dine.Cili eshte rreziku i sigurise kombtare qe ka sjelle kjo drejtuese?

↩ [Përgjigjuni](#)

👍 2 🗳️ 0 ❤️ 1

D

Dardan

22 Shtator 2026, 20:35

Si ka mundesi qe Citaku te arrestohet pa pelqimin e Beogradit, ose te pakte te Baton Haxhiut?!

↩ [Përgjigjuni](#)

👍 0 🗳️ 2 ❤️ 0

H

hila

22 Shtator 2026, 21:38

Dardan, vec me pelqimin e beogradit do veprohej ashtu, nuk munde te pritej sa te kthehej ne Shqipni e pastaj te arrestohej. Veec Ruse kane vepru ne kete menyre me kundershtaret qe kan pas frige.

↩ [Përgjigjuni](#)

👍 1 🗳️ 0 ❤️ 0

Q

Qafe thane piçke sames

22 Shtator 2026, 21:22

Shqiperine e mori SPAK-u l vu zjarre /shqiptare mos rri po duku shqiptetar

↩ [Përgjigjuni](#)

👍 1 🗳️ 0 ❤️ 0

E

Edi Rama në qendër

22 Shtator 2026, 21:46

Të gjithë njerëzit e Kryeministrit!

↩ [Përgjigjuni](#)

👍 2 🗳️ 0 ❤️ 0

M

Malua

22 Shtator 2026, 23:03

Ca thua?!U rrenqethem,c'na gjeti!O shok po ku ka nderkombetar qe nuk e di cfare llumi drejton ne Shqiperi keto 35 vite.Nga ana tjeter avash pak kur pretendon se ky lloj llumi do ndikoje ne situatat me Kosoven,pu pu pu mos u beni qesharak te pakten me ato qe shkruani.Te garantoj qe te gjithë shqiptaret jane te qarte se cfare kane gatuar keto vite dhe jane gjithashtu te qarte qe keto jane pasoja qe do zgjasin(ndoshta edhe nja 3 breza e pa le ca behet).Prandaj,lerini te behet ndonje arrestim,thyejme pak monotonin,shohim ndonje gje ndryshe.Jo vetem vrasje,vjedhje,ikje,ardhje,etj!

↩ [Përgjigjuni](#)

👍 0 🗳️ 0 ❤️ 0



Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Humbëm betejën, por lufta vazhdon...](#)

11:41 Blog / 1 koment



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.